## KËRKESË PËR INFORMACION

| **Emër Mbiemër[1]:**<br>Z. Roden Hoxha | **Adresa postare: Rruga Pjetër Budi 69, Tiranë**<br>**Adresa elektronike**: rodenhoxha@gmail.com<br>**Nr. Tel**: 0695534646 | Data: 20.07.2025<br>Nënshkrimi:<br>Roden HOXHA |
|---|---|---|

**Autoriteti Publik : Bashkia**

| **Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar** |
|---|

Referuar hidrocentraleve që po ndërtohen apo që operojnë në territorin e bashkisë tuaj, kërkoj, si vijon:

**Gjendja e HEC-eve:**

1. Listen e HEC-eve (emrat e tyre, lumenjtë dhe degët e lumenjve mbi të cilat po ndërtohen, apo operojnë) që ndodhen në territorin e bashkisë?
2. Njësitë administrative (apo fshatrat) në rë cilat janë vendosur këto HEC-e.
3. Njësitë administrative (apo fshatrat ) në rë cilat janë vendosur panelet fotovoltaike (nëse ka).
4. Njësitë administrative (apo fshatrat) në të cilat janë vendosur turbinat e erës (nëse ka).#
5. Ju lutem të specifikoni HEC-et që ndodhen (apo kalojnë) brenda territoreve te zonave të Mbrojtura

**Të ardhura nga HEC-et:**

6. Një listë të zërave të të ardhurave që merr bashkia nga një HEC që operon në territorin e saj (Psh., a merr taksë mbi pasurinë e paluajtshme, taksë për ndërtesa, taksë trualli, taksë tabele, të ardhura nga qiratë për troje, taksë ujësjellës kanalizime, tarifë vendore për hecin ujor, tarifë pastrimi dhe largimi të mbeturinave, tarifë për dhënie me kontratë qiraje nga fondi pyjor dhe kullosor, tarifë e shërbimit administrativ, tarifë e shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri, tarifë e mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore?).
7. Sa ishin të ardhurat e grumbulluara nga operimi i HEC-eve në vitin 2024?
8. A keni vendosur ndonjë taksë për dëmin që shkakton veprimtarimtaria e HEC-it në mjedis? Nëse po, në ç'kushte aplikohet, ç'vlere ka? Sa ishte vlera e përgjithshme që u përfitua për vitin 2024?

**Të dhëna për mjedisin/habitatin:**

9. Sa është sipërfaqja e përgjithshme që sipas kërkesës së kompanive koncensionare (në hektarë) është hequr nga fondi pyjor dhe kullosor dhe është vënë në dispozicion të projekteve të ndërtimit të HEC-eve (apo të paneleve diellore dhe të turbinave të erës, nëse ka)?
10. Sa nga kjo sipërfaqe i takon paneleve fotovoltaike dhe sa i takon turbinave të erës (nëse ka)?
11. A ka bashkia marrërveshje me secilën prej kompanive koncensionare, lidhur me përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër nga kompanitë në fjalë, mbi zbatimin e angazhimeve të marra në favor të komunitetit, apo të mjedisit natyror, me qëllim zbutjen e pasojave që munnd të shkaktohen nga operimi i HEC-it? Nëse po, kërkoj kopje të këtyre marrëveshjeve.
12. A kanë banorët (në dijeninë tuaj, ndoshta përmes kryepleqve) marrëveshje të shkruar më kompanitë e HEC-eve, që mundëson përdorimin e përkohshëm të rrjedhës së ujit në favor të fermerëve vendas gjatë sezonit të vaditjes? Nëse po, ju lutem nga një kopje të marrëveshjeve.
13. Kopje të plotë të realizimit të buxhetit për vitin 2024, që përfshin realizimin e të ardhurave dhe realizimin e shpenzimeve.

| Të tjera të dhëna |
| --- |
| |

| Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni: Elektronike përmes email |
| --- |
| ________________________________________ |

| Vetëm për përdorim zyrtar | | |
| --- | --- | --- |
| Data e marrjes: __/__/201_ | Numri rendor i kërkesës: | Komente: ________________<br>________________<br>________________ |

| Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale". |
| --- |

- Adresa dhe kontaktet mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al, *portalit pyetshtetin.al* apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik.
- Drejtoni kërkesën tuaj, Koordinatorit për të drejtën e informimit, të institucionit që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij, janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Ju mund të dërgoni një kërkesë edhe nëpërmjet portalit *pyetshtetin.al*
- Kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.